



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.495/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje LVV, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.02.2025, merr këtë:

VE N D I M

I. PRANOHET TE BAZUARA ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës PDK, me seli në Komuna Prishtinë, A.nr.495/2025 datë 0.02.2025 dhe ankesa A.nr.499/2025 e dt. 09.02.2025

II. Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 2,000.00Euro (dymije) Euro.

III. Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar ankesat: Anr.495/2025, Anr.499/2025, më datë 09.02.2025

-Në ankesën Anr.495/2025 pretendohet se më datë 09 shkurt 2025, mbështetësi i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, z. Faruk Mujka ka publikuar një fotografi në rrjetin social Facebook pas hapjes së vendvotimeve, respektivisht pas orës 07:00/h, me tekstin përshkrues "Një kontribut i vogël për një qëllim extra të madh 118 për 500k" i cili në mënyrë indirekte ka bërë fushatë përmes thirrjes për të votuar subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje.

-Në ankesën Anr.499/2025 pretendohet se më datë 09 shkurt 2025, mbështetësi i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, z.Asdren Gashi ka publikuar një fotografi në rrjetin social Facebook, pas hapjes së vendvotimeve, respektivisht pas orës 07:00/h, me tekstin përshkrues "Sot është dita e demokracisë të vetëvendosim mes Kosovës sot të zhvilluar e me sovranitet, apo Kosovës dikur të lodhur e pa sovranitet! Unë vetëvendosja vendos edhe ti!", i cili në mënyrë indirekte ka bërë fushatë përmes thirrjes për të votuar subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje.

Si provë në ankesat subjekti politik PDK, ka bashkangjitur postimet e publikuara në rrjetin social facebook.

-Në përgjigjen në ankesën A.nr.495/2025 Lëvizja Vetëvendosje ka theksuar se ankesa e tillë, është e pabazë dhe e paqëndrueshme, kjo për faktin se e njëjta, nuk përmban ndonjë fakt dhe provë të cilat do ta ndërlidhnin shkeljen e pretenduar si shkelje e cila do të binte ndesh me dispozitat e LZP-së. LVV ka njoftuar të gjithë strukturën dhe aktivistët për rregullat zgjedhore, në veçanti ato të cilat kanë të bëjnë me respektimin e heshtjes zgjedhore, për më shumë, postimi i tillë për të cilin në ankesë pretendohet se është shpërndarë, nuk qëndron si i tillë, rrjedhimisht është fshirë nga rrjeti social.

Si provë ka bashkangjitur linkun:

<https://www.facebook.com/fmuika/posts/10227631593002890>

-Në përgjigjen në ankesën A.nr.499/2025 Lëvizja Vetëvendosje ka theksuar se ankesa e tillë është e pabazë dhe e paqëndrueshme, kjo për faktin se teksti nuk përmban elemente të cilat do ta ndërlidhnin shkeljen e pretenduar si shkelje e cila do të binte ndesh me dispozitat e LZP-së. Posti i tillë me fotografitë dhe tekstin përkatës, nuk përmban llogo, slogan apo numër për të promovuar ndonjë kandidat apo subjekti politik, por përdorë fjalë të cilat janë të lejueshme sipas gjuhës shqipe dhe që kanë kuptim përmbajtësor. Për me tepër një tekst i tillë nuk bie ndesh me asnjë dispozitë të nenit 8 të Rregullores Zgjedhore nr.07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr. 01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi I të Ligjit Nr. 05/1,-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si ne vijim: Anr.495/2025 dhe Anr.499/2025, të datës 09.02.2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët Anr.495/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga dy subjekte politike kundër subjektit të njëjtë politik LVV për shkeljen e njëjtë, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

Ankesat janë të pabazuara

Paneli pas vlerësimit të ankesave dhe provave të bashkangjitura në ankesë të cituara më lartë si dhe përgjigjes në ankesë dhe provat e bashkangjitura në të, erdhi në përfundim se pretendimet e ankuesit në ankesat e tyre, se mbështetësit e subjektit politik LVV ka thyer

heshtjen zgjedhore për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, ku njëri nga mbështetësit e subjektit politik LVV ka postuar në rrjetin social facebook me tekstin "Një kontribut i vogël për një qëllim extra të madh 118 për 500k", ndërsa mbështetësi tjetër i subjektit politik LVV ka postuar në rrjetin social facebook me tekstin "Sot është dita e demokracisë të vetëvendosim mes Kosovës sot të zhvilluar e me sovranitet, apo Kosovës dikur të lodhur e pa sovranitet! Unë vetëvendosa vendos edhe ti!", janë të bazuara, dhe më të njëjtin veprim subjekti politik ka bërë shkelje të nenit 37 paragrafi 2 të Ligjit NR. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës konkretisht neni 37, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i LZP-së parasheh: *Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: 1.2. bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.*

Paneli ka konsideruar këtë veprim si shkelje të nenit 37, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi veprimi është bërë në rrjetin social e që ka për qëllim ndikimin tek votuesit.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", Paneli vlerësoj se pretendimet në ankesat janë të qëndrueshme dhe si të tilla i pranoi, sepse kjo shkelje ka të bëjë me faktin se Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë ditës së votimit, veprimet e subjekteve politike të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit se nga veprimet e përshkuara në ankesa nga parashtruesit e ankesave paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtat i pranoi si të bazuara.

Paneli, me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes si dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë. Kjo konsiston në faktin se Subjekti Politik LVV ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të votimit.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 dhe neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.495/2025 më datën 11.02.2025.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa ne kuptim të nenit 118.4 të LZP-së.